

FOLICUR EW 250

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

FOLICUR EW 250 është fungicid sistemik, me veprim parambrojtës, kurues dhe çrrënjësës.

Përmban: *Tebuconazole 250 gr/lit;*
Formulimi: *Emulsion ujqor (EW);*
Pamja: *Lëng me ngjyrë të verdhëremë.*

Frazat e rrezikut dhe kujdesit:

H302+H332 E dëmshme nëse gëlltitet ose nëse thithet.

H318 Shkakton dëmtim të rëndë syri.

H335 Mund të shkaktojë irritim në frymëmarrje.

H360 Mund të dëmtojë fertilitetin apo fëmijën e palindur.

H410 Për te shmangur për jetën ujore me efekte afatgjata.

P280 Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën/ sytë.

P305+P351+338 Shpëljani me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit nëse kenit.

P310 Menjëherë telefononi një qendren e helmimit apo një doktor/mjek.

Masat parambrojtëse:

- Mbajeni në vende të sigurta dhe të paaritshme nga femijet.
- Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lekures me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit sperkates dhe gjatë sperkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Në perfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet sperkatese, duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.
- Beni shkaterimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast marrje me organet e frymëmarrjes, nxireni të dëmtuarin në ajër të pastër.
- Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Në rast kontakti me lëkurën, hiqni rrobat e ndotura, lani menjëherë pjesët e kontaminuara me ujë të bollshëm dhe sapun. Kërkoni ndihmë mjekësore.
- Në rast kontakti me sytë, shplajini ata me ujë të bollshëm. Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Në rast se produkti është gëlltitur, mos shkaktoni të vjella. Shpëljani menjëherë gojën. Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.

Përdorimi:

Në hardhi, kundër hirit (*Uncinula necator*), me 30 ml/100 lit ujë (0.4 lit/ha preparat). Trajtimet fillojnë nga faza e 3-5 gjetheve dhe përsëriten çdo 14 ditë. Nuk rekomandohen më shumë se 4 trajtime në sezon. Kontrollon gjithashtu kalbëzimin e zi (*Guignardia bidwelli*) dhe njolloshjen e kuqe të gjetheve (*Pseudopeziza spp.*).

Në pjeshkë e kajsi, kundër hirit të pjeshkës (*Sphaerotheca pannosa*) dhe kalbëzimit të frutave (*Monilinia spp.*), me 50-60 ml/100 lit ujë. Trajtimet përsëriten çdo 14 ditë.

Në domate, kontrollon alternarien (*Alternaria solani*), kalbëzimin (*Botrytis cinerea*), hirin (*Erysiphe polygoni*) si

dhe septorien (*Septoria lycopersici*), duke përdorur 0.6-0.8 lit preparat/ha.

Në lakër e lulëlakër, kontrollon alternarien (*Alternaria brassicicola*) dhe hirin (*Erysiphe cruciferarum*), duke përdorur 0.5-0.8 lit preparat/ha.

Në qepë, hudhra e pras, kontrollon alternarien (*Alternaria porri*), kalbëzimin (*Botrytis allii*) dhe ndryshkun (*Puccinia allii*) me 0.6-1 lit/ha preparat.

Në të lashta, kontrollon shumë sëmundje si: hirin, ndryshkun, fuzariozat, alternarien, septoriozen, duke përdorur 0.6-0.8 lit/ha preparat. Përdoret gjithashtu në shumë kultura të tjera.

Në të gjitha kulturat, trajtimet fillojnë me shfaqjen e infeksionit dhe përsëriten çdo 2 javë.

Vërejtje për përdorimin:

Megjithatë Folicur ka veprim parambrojtës, kurues dhe çrrënjësës, rezultatet më të mira arrihen kur përdoret si parambrojtës ose në stadet e para të zhvillimit të sëmundjes.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe me dozat e rekomanduara. Nuk duhet përdorur në pemët frutore farore, sepse disa varietete janë të ndjeshëm ndaj këtij formulimi.

Ndikimi në ekosistem:

Helmues për organizmat ujore. Mos ndotni ujrat dhe burimet ujore që rrjedhin në lumenj e rezervuarë uji.

Karenca:

vreshti 14 ditë; ë lashtat 28 ditë; perimet dhe pemët frutore 7 ditë.

Ruajtja dhe magazinimi:

Ruhet në vende të thata, të ajrosura, në ambalazhin origjinal, në temperatura -10°C deri 40°C.

Nr dhe data e regjistrimit: 242/1; 18.3.2011;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 10-1000 ml.

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 4 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit baze: Shishe HDPE.

Emri dhe adresa e Aplikantit: Bayer CropScience AG. **Adresa:** Leverkusen, Gjermani..

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Bayer CropScience AG. **Adresa:** Leverkusen, Gjermani.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet në Republikën e Shqipërisë):